

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë rregulla lidhur me pozicionin, kriteret e përzgjedhjes, pamundësinë në kryerjen e funksionit, shkaqet dhe procedurën e shkarkimit të Presidentit të Republikës, ushtrimin e kompetencave kushtetuese, statusin e tij/e saj dhe të anëtarëve të familjes së tij/saj, gjatë dhe pas mbarimit të mandatit, si dhe organizimin e brendshëm të institucionit të Presidentit të Republikës.

#### **Neni 2**

##### **Roli kushtetues**

Presidenti i Republikës si Kryetar i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit ka rol neutral në raport me pushtetet politike.

### **Neni 3**

#### **Selia**

Selia e Presidentit të Republikës ndodhet në kryeqytet.

### **Neni 4**

#### **Simbolet**

Simbolet e Presidentit të Republikës përdoren krahas simboleve të Republikës.

## **KREU II**

### **Neni 5**

#### **Kriteret e zgjedhjes**

1. President i Republikës mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim të pandërprerë, jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.

2. Lejohet kandidimi vetëm i shtetasve shqiptarë, të cilët i nenshtrohen procesit të verifikimit të plotë të pasurisë dhe të figurës, si dhe të të dhënave të tjera të vetëdeklaruar sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

### **Neni 6**

#### **Betimi dhe fillimi i ushtrimit të detyrës së Presidentit**

1. Presidenti fillon ushtrimin e detyrës pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim: "Betohe se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar".

2. Kryetari i Kuvendit lexon formulën e betimit, sipas neni 88 pika 3 të Kushtetutës. Presidenti, duke e vendosur dorën mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, deklaron: "Betohe" (Presidenti mund të shtojë "Zoti më ndihmoftë").

3. Pas leximit të tekstit të betimit, Presidenti i Republikës nënshkruan aktin e betimit. Akti i betimit të Presidentit të Republikës i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe depozitohet në Kuvendin e Shqipërisë.

4. Ceremonia e betimit të Presidentit të Republikës transmetohet drejtpërdrejt nga televizionet kombëtare shqiptare.

5. Pas nënshkrimit të aktit të betimit të Presidentit të Republikës këndohet Himni Kombëtar. Kryetari i Kuvendit fton Presidentin për të mbajtur fjalën përshëndetëse para

Kuvendit. Kryetari i Kuvendit uron Presidentin për detyrën dhe deklaron mbylljen e seancës plenare.

## Neni 7

### **Pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve**

1. Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private.
2. Çdo detyrë ose funksion politik, publik, ose privat, i zgjedhur ose i emëruar, i ushtruar para zgjedhjes si President i Republikës përfundon pas zgjedhjes nga Kuvendi i Shqipërisë.

## Neni 8

### **Shkaqet dhe procedura e shkarkimit të Presidentit**

1. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit për këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit.
2. Kërkesa duhet t'i paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit dhe të përmbajë në mënyrë të motivuar dhe konkrete shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose kryerjen e një krimi të rëndë. Me paraqitjen e propozimit, Kryetari i Kuvendit vë menjëherë në dijeni Kuvendin dhe Presidentin e Republikës.
3. Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t'u dëgjuar në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë. Procedura e detajuar e shkarkimit, në respektim të standardeve të procesit të rregullt ligjor, rregullohet nga Rregullorja e Kuvendit.
4. Kuvendi vendos për shkarkimin e Presidentit të Republikës, me jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij dhe me votim të fshehtë. Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës i dërgohet Gjykatës Kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Procedura e shqyrtimit të vendimit të Kuvendit rregullohet nga Ligji organik i Gjykatës Kushtetuese.

## Neni 9

### **Pamundësia në ushtrimin e funksioneve dhe vakanca**

1. Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij.
2. Pamundësi e përkohshme do të konsiderohet ajo gjendje fizike dhe mendore në të cilën ndodhet Presidenti i Republikës, që e bën të pamundur ushtrimin në mënyrë efektive të funksioneve të përcaktuara nga Kushtetuta. Nëse pamundësia e përkohshme zgjat për më shumë se 60 ditë ajo kthehet në pamundësi e përhershme.
3. Kur Presidenti ndodhet në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij dhe është në gjendje të vetëdijshme, ai i kërkon Kryetarit të Kuvendit zëvendësimin e tij. Në rast se Presidenti është në gjendje të pavetëdijshme, atëherë, Kuvendi, bazuar mbi vendimin e një komisioni të caktimit të aftësisë për punë, i cili vërteton faktin e pamundësisë

shëndetësore, vendos zëvendësimin e Presidentit të Republikës nga Kryetari i Kuvendit. Procedura të hollësishme mbi ngritjen dhe funksionimin e këtij komisioni përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit.

4. Presidenti zëvendësohet nga Kryetari i Kuvendit sipas vendimit të Kuvendit edhe kur vendi mbetet vakant, për shkak të vdekjes, dorëheqjes, shkarkimit, pamundësisë së përhershme të ushtrimit të funksionit për shkaqe shëndetësore fizike dhe mendore, ose gjatë kohës midis përfundimit të mandatit të Presidentit, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, dhe zgjedhjes së Presidentit të ri.

5. Në rast se Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

### **KREU III**

## **KOMPETENCAT KUSHTETUESE**

### **SEKSIONI I**

## **MARRËDHËNIET ME PUSHTETIN LEGJISLATIV**

### **Neni 10**

#### **Thirrja e mbledhjes së Kuvendit pas zgjedhjeve**

1. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast të mosushtrimit të kësaj kompetence nga Presidenti i Republikës, Kuvendi vetëmbledhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Neni 11**

#### **Thirrja e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit**

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm.

2. Presidenti i Republikës i drejtohet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe i kërkon thirrjen në sesion të jashtëzakonshëm, për çështje të rëndësishme shtetërore dhe politike, duke e motivuar arsyen e thirrjes, bashkëshoqëruar me një program paraprak.

### **Neni 12**

## **Thirrja e mbledhjeve me dyer të mbyllura të Kuvendit**

1. Presidenti i Republikës mund t'i kërkojë Kuvendit zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura.
2. Pas dëgjimit të kërkesës dhe diskutimeve rreth saj, Kuvendi vendos, me votim të hapur me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### **Neni 13**

#### **Emërimi dhe shkarkimi i Kryeministrit**

1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin, me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.
2. Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve, sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, me propozim të partisë ose koalicionit të partive, në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi.
3. Kryeministri i propozon Presidentit kabinetin qeveritar, i cili dekreton Kryeministrin bashkë me ministrat. Kryeministri me ministrat votohen bashkë me programin politik, në të njëjtën seancë.
4. Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.
5. Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, sipas pikës 4 të këtij neni.

### **Neni 14**

#### **Emërimi dhe shkarkimi ministrave**

1. Presidenti, me propozim të Kryeministrit brenda 7 ditëve, shprehet me dekret për emërimin ose shkarkimin e ministrave.
2. Në rastet kur vendi i Ministrit mbetet vakant, Kryeministri i propozon Presidentit emërimin e një ministri tjetër. Presidenti brenda 7 ditëve shprehet në dekret për largimin e ministrit dhe emërimin e ministrit të ri.
3. Pasi dekretet e emërimit janë votuar "pro" nga Kuvendi, Ministrat bëjnë betimin para Presidentit, brenda një jave nga dhënia e pëlqimit të Kuvendit.

### **Neni 15**

#### **Shpallja e ligjit**

1. Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Ligji dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 ditëve nga njoftimi i dekretit të Presidentit për shpalljen e ligjit, por, në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga data e dekretit.
2. Në qoftë se Presidenti i Republikës nuk e shpall ligjin brenda afatit të pikës 1 të këtij neni si dhe pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji, atëherë ligji konsiderohet i shpallur. Në këtë

rast, ligji dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 ditëve nga kalimi i afatit kushtetues për shpalljen ose kthimin për rishqyrtim të ligjit. Kuvendi shënon edhe datën e dërgimit të ligjit të miratuar Presidenti i Republikës.

3. Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve, Presidenti i Republikës jep pëlqimin me dekret për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit, duke u shprehur njëkohësisht edhe për shpalljen e ligjit. Në këtë rast, ligji njoftohet publikisht nga Kuvendi dhe ligji hyn në fuqi menjëherë. Ky ligj botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

4. Nëse Presidenti i Republikës nuk jep pëlqimin, atëherë ligji hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të nenit 84, pika 1 e Kushtetutës.

## Neni 16

### E drejta e kthimit të ligjit për rishqyrtim në Kuvend

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim në Kuvend vetëm një herë.

2. Dekreti i Presidentit duhet të jetë i motivuar mbi arsyet e kthimit, duke iu referuar ligjit në tërësi ose dispozitave të vecanta të tij.

3. Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë dekretin për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti shqyrtohet nga komisioni përgjegjës vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës. Komisioni brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij, i cili përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

4. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë kur votojnë kundër shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

5. Pas votimit kundër të dekretit sipas pikës 4 të këtij neni, ligji dërgohet nga Kuvendi, për publikim në Qendrën e Publikimeve Zyrtare, brenda 5 ditëve nga data e votimit kundër tij.

## Neni 17

### Kompetenca të tjera në lidhje me Kuvendin

Presidenti ushtron edhe këto kompetenca në raport me Kuvendin:

- a) I drejton mesazhe Kuvendit, në fillim ose gjatë legjislatures, në lidhje me veprimtarinë e Kuvendit, nëpërmjet fjalimeve personalisht, ashtu dhe duke iu drejtuar me shkrim Kuvendit. Në këto raste, mesazhet lexohen në seancë plenare të hapur të Kuvendit nga drejtuesi i seancës, ku mund të ftohen dhe personalitetet e rëndësishëm të vendit dhe të huaj.
- b) Cakton me dekret datën e zgjedhjeve për Kuvendin;
- c) Shpall ligjin e miratuar me referendum;
- d) Dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e Kryeministrit të zgjedhur brenda 10 ditëve nga votimi i mocionit në Kuvend, në rastin kur më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit votojnë mocionin e mosbesimit ndaj Kryeministrit dhe zgjedhin një kryeministër të ri, referuar nenit 105 të Kushtetutës;
- e) Shpërndan Kuvendin, kur ky nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, sipas nenit 96, pika 4 dhe 104, pika 2 të Kushtetutës;

- f) Cakton me dekret datën e zhvillimit të referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë, dhe të referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një ligji, kur për këtë paraqesin kërkesë 50 mijë shtetas me të drejtë vote. Data e zhvillimit të referendumëve caktohet nga Presidenti brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese, që ka deklaruar paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum ose pas kalimit të afatit prej 60 ditësh, brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehej.
- g) Cakton me dekret datën e zhvillimit të referendumit kushtetues, sipas nenit 177, pika 4 dhe pika 5 të Kushtetutës.

## SEKSION 2

### MARRËDHËNIET ME SISTEMIN E DREJTËSISË

#### Neni 18

##### Emërimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Presidentin e Republikës, i cili, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit, shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a paraqiten pranë Presidentit të Republikës, i cili ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

2. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, thërret mbledhjen e Këshillit që shqyrton plotësimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore nga kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes është publik dhe përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kriterëve të emërimit, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit. Lista shoqërohet nga një raport me shkrim ku analizohet plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për secilin kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.

4. Presidenti brenda 30 ditëve nga marrja e listës prej Këshillit të Emërimeve në Drejtësi emëron gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Dekreti i emërimit shpallet i shoqëruar me arsyet e përzgjedhjes së kandidatit. Nëse Presidenti nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Dispozita e transferuar nga ndryshimet e reja të ligjit organik të GJK, neni 7/b.

## Neni 19

### Emërimi i anëtarëve të Gjykatës së Lartë

1. Presidenti i Republikës emëron anëtarët e Gjykatës së Lartë, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.<sup>2</sup>

## Neni 20

### Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.<sup>3</sup>

## Neni 21

### Roli i Presidentit në paraqitjen dhe shqyrtimin e aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit

1. Presidenti i Republikës shpall menjëherë thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit në faqen zyrtare të internetit, si dhe në dy gazeta me tirazhin më të lartë në vend. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare ku duhet të dorëzohet dhe listën e dokumenteve që duhet të shoqërojnë atë.

2. Afati për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues është 15 ditë.

3. Kërkesa e kandidatit regjistrohet në regjistrin e protokollit të Presidentit të Republikës. Kandidati pajiset me një dokument që vërteton numrin e aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.

<sup>2</sup> Dispozitë e transferuar nga neni 136/2 i Ndryshimeve Kushtetuese.

<sup>3</sup> Dispozitë e transferuar nga neni 149/d, pika 3 e Ndryshimeve Kushtetuese.

4. Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant për të cilin është i interesuar të aplikojë. Në rast se kandidati nuk ka përcaktuar asnjë preferencë për vendin vakant, konsiderohet që ai aplikon për të gjithë vendet vakante. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 2 (dy) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- b) kopje të noterizuara ose të njehsuara të diplomës nga organi përkatës;
- c) kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njehsuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;
- d) Një dokument të nënshkruar prej tij me të cilin aplikuesi pranon kufizimet e posaçme për fshehtësinë në komunikimet elektronike gjatë kohëzgjatjes së mandatit si anëtar i institucioneve të rivlerësimit, sipas Shtojcës 1 të këtij ligji.

5. Brenda 7 ditëve nga përfundimi i procesit të aplikimit, Presidenti i Republikës, pasi konsultohet me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, përpilon një listë me kandidatët të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatët të cilët nuk i plotësojnë këto kriteret. Operacioni ndërkombëtar i monitorimit monitoron këtë proces, duke patur akses të plotë në dokumentacionin e të gjithë aplikantëve.

6. Presidentit i Republikës, menjëherë ia përcjell Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, listat e përpiluara sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe të gjitha dosjet individuale të kandidatëve, si dhe publikon listën e plotë të kandidatëve në faqen zyrtare të internetit, të grupuar sipas secilit pozicion. Në rast se Presidenti i Republikës nuk përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi të Aneksit të Kushtetutës, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët. Jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e dy listave nga Presidenti i Republikës, ky komision, bazuar në vlerësimet e arsyetuara, lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, i dërgon rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit<sup>4</sup>.

### SEKSIONI 3

## MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E PARASHIKUARA NGA KUSHTETUTA

### Neni 22

#### Procedura e përzgjedhjes së Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë

<sup>4</sup> Dispozitë e transferuar nga ligji për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 7 i këtij ligji.

1. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Guvernatori kryeson Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2. Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit kandidaturën për Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, pas konsultimit me Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

3. Presidenti i Republikës, 60 ditë përpara mbarimit të mandatit të Guvernatorit, ose menjëherë në rast se mandati përfundon në mënyrë të parakohshme, krijon një komision të posaçëm përgjegjës për njoftimin e kandidatëve, për mbledhjen e dosjeve personale të tyre, për përgatitjen e listës me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe për përgatitjen e relacionit për Presidentin.

4. Komisioni përbëhet nga të paktën 3 anëtarë, ekspertë në fushën bankare, të financës, ekonomisë dhe/ose të së drejtës.

## Neni 23

### Veprimtaria e Komisionit të posaçëm

1. Komisioni, brenda 5 ditëve nga krijimi, publikon njoftimin për aplikim për pozicionin e Guvernatorit të BSH. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Institucionit të Presidencës, në të paktën në dy gazeta me shpërndarje dhe tirazh kombëtar, si dhe në dy televizione kombëtare njëri prej të cilëve është Radio Televizioni Publik Shqiptar.

2. Njoftimi përmban dokumentacionin e nevojshëm për t'u paraqitur, afatin e paraqitjes dhe mënyrën e dërgimit të tij, sipas kriterëve të parashikuara në Ligjin për Bankën e Shqipërisë.

3. Komisioni bën publike listën e kandidatëve, brenda ditës së nesërme të punës nga dita e mbarimit të afatit të paraqitjes.

4. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe në përfundim të procesit të vlerësimit harton një relacion për Presidentin, ku argumenton plotësimin e kriterëve dhe afateve për çdo kandidat që ka aplikuar. Në përfundim të punës, Komisioni publikon listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret.

## Neni 24

### Propozimi i Presidentit

1. Presidenti i Republikës, brenda 5 ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve për Guvernator, konsultohet me Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2. Në përfundim të konsultimit, Presidenti i propozon Kuvendit të Shqipërisë emrin e kandidatit për Guvernator. Propozimi shoqërohet me relacionin shpjegues të të gjithë ecurisë së procesit konsultues dhe vlerësues.

## Neni 25

### Procedura e përzgjedhjes së Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, për një mandat 7-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

2. Presidenti i Republikës 60 dite para mbarimit të mandatit 7-vjekar të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ose menjëherë në rast se mandati përfundon në mënyrë të parakohshme, krijon një komision të posaçëm përgjegjës për njoftimin e kandidatëve, për mbledhjen e dosjeve personale të tyre, për përgatitjen e listës me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe për përgatitjen e relacionit për Presidentin.

3. Komisioni përbëhet nga të paktën 3 anëtarë, ekspertë që përfaqësojnë botën akademike, fushën e auditit si dhe ekspertë të pavarur. Përfaqësues nga institucione të tjera auditimi mund të marrin pjesë me statusin e vëzhguesit të procesit. Komisioni vepron sipas parashikimeve të njëjta, të përcaktura në nenin 21 të këtij ligji, në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të kandidaturave, vlerësimin si dhe publikimit të listës së kandidatëve.

## **Neni 26**

### **Propozimi i Presidentit**

Presidenti i Republikës, brenda 5 ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve për Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i propozon Kuvendit të Shqipërisë emrin e kandidatit për Kryetar. Propozimi shoqërohet me relacionin shpjegues të të gjithë ecurisë së procesit konsultues dhe vlerësues.

## **SEKSIONI 4**

### **KOMPETENCAT E PRESIDENTIT NE MARRËDHËNIET ME JASHTË**

## **Neni 27**

### **Kompetenca të përgjithshme**

Presidenti i Republikës i ushtron kompetencat e tij në fushën e marrëdhënieve me jashtë në përputhje me objektivat e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë. Në ushtrimin e këtyre kompetencave ai bashkërendon punën me organet kushtetuese të ngarkuara me hartimin dhe zbatimin e objektivave të politikës së jashtme.

## **Neni 28**

### **Kompetenca në lidhje me Shërbimin e Jashtëm**

1. Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin për shërbimin e jashtëm.

2. Presidenti lëshon letrat kredenciale për përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare pas marrjes së pëlqimit/dakordësisë prej tyre nga shteti apo organizata ndërkombëtare ku janë akredituar.

3. Presidenti, pas konsultimit me Ministrin e Punëve të Jashtme, pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 29

### Kompetenca për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Presidenti i Republikës lidh marrëveshje ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin përkatës për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

2. Presidenti i Republikës autorizon Ministrin e Punëve të Jashtme të lëshojë plotfuqinë për negociimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare që lidhet në emër të Republikës së Shqipërisë.

3. Procedura e dhënies së autorizimit nga Presidenti i Republikës për lëshimin e plotfuqive për marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohet nga legjislacioni për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 30

### Përfaqësimi në aktivitete ndërkombëtare

1. Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin shqiptar në aktivitete ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, brenda dhe jashtë vendit në përputhje me normat e ceremonialit shtetëror. Ai autorizon Ministrin e Punëve të Jashtme që të lëshojë kredencialet për pjesëmarrjen e delegacioneve shtetërore në aktivitetet ndërkombëtare shumëpalëshe në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Procedura për lëshimin e kredencialeve për pjesëmarrjen e delegacioneve në konferencat ndërkombëtare rregullohet nga legjislacioni për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë:

- a) Kredencialet për pjesëmarrjen në konferencat ndërkombëtare që autorizohen nga Presidenti i Republikës sipas legjislacionit për marrëveshjet ndërkombëtare lëshohen për të gjitha delegacionet që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, ku përfaqësimi është sipas formulës Kryetari ose/dhe i Këshillit të Ministrave.
- b) Autorizimi i lëshuar nga Presidenti i Republikës bëhet vetëm me shkrim.
- c) Format i autorizimit që lëshohet nga Presidenti i Republikës dhe i reflektimit të autorizimit në kredencialet që lëshohen nga Ministri i Punëve të Jashtme, do të bëhen sipas një procedure të miratuar mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Institucionit të Presidentit të Republikës, për këtë qëllim, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

## SEKSIONI 5

### MARRËDHËNIET NË FUSHËN E MBROJTJES

## Neni 31

## **Emërimi, gradimi, shkarkimi dhe nxjerrja në rezervë ose në lirim të oficerëve me grada madhore**

1. Presidenti i Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, emëron, gradon, shkarkon dhe nxjerr në rezervë ose në lirim oficerë me grada madhore, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi mbi pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Presidenti i Republikës, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së propozimeve, shprehet me dekret të arsyetuar në rast të refuzimit të propozimit. Në rast se Presidenti nuk shprehet brenda afatit ligjor, heshtja do të konsiderohet refuzim i propozimit.

### **Neni 32**

#### **Këshilli i Sigurimit Kombëtar**

1. Presidenti i Republikës kryeson Këshillin e Sigurimit Kombëtar, i cili funksionin si organ këshillimor për të asistuar Presidentin në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të tij kushtetuese e ligjore mbi çështjet e sigurisë, mbrojtjes, armë-kontrollit dhe çdo çështje tjetër të fushës së sigurisë kombëtare.

2. Këshilli i Sigurimit Kombëtar kryesohet nga Presidenti i Republikës dhe thirret prej tij sa herë që e gjykon të nevojshme e sipas një rendi dite të përcaktuar.

3. Anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit Kombëtar janë:

- a) Kryetari i Kuvendit;
- b) Kryeministri;
- c) Ministri i Mbrojtjes;
- ç) Ministri Punëve të Jashtme;
- d) Ministri i Drejtësisë;
- dh) ministri përgjegjës për punët e brendshme;
- e) ministri përgjegjës për financat;
- ë) ministri përgjegjës për transportin;
- f) ministri përgjegjës për energjinë;
- g) kryetari i komisionit të përhershëm parlamentar, përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes;
- gj) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- h) Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit;
- i) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

4. Në raste të veçanta, Presidenti i Republikës mund të ftojë pjesëmarrës të tjerë.

5. Në rast se anëtarët e Këshillit të Sigurimit Kombëtar për arsye objektive nuk mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, ata autorizojnë zëvendësit e tyre, duke marrë miratimin paraprak të Presidentit.

6. Këshilli i Sigurimit Kombëtar diskuton dhe jep mendime për çështje të sigurisë, të mbrojtjes, të armë-kontrollit dhe për çdo çështje tjetër në fushën e sigurisë kombëtare.

7. Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk merr vendime.

8. Mbledhjet e tij zhvillohen të mbyllura.

9. Këshilli i Sigurimit Kombëtar vepron sipas Rregullores së organizimit dhe funksionimit të tij, të dalë në zbatim të këtij ligji, si dhe ligjeve të fushës së sigurisë, mbrojtjes, armë-kontrollit dhe çdo ligji tjetër të fushës së sigurisë kombëtare.

## Neni 33

### Masat e jashtëzakonshme

1. Në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës.

2. Presidenti i Republikës i paraqet Kuvendit dekretin për vendosjen e gjendjes së luftës brenda 48 orëve nga nënshkrimi i tij, duke specifikuar të drejtat që kufizohen. Dekreti i Presidentit merret në shqyrtim menjëherë nga Kuvendi, i cili vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve.

3. Në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, Presidenti i Republikës, i propozon Kuvendit, të shpallë gjendjen e luftës, të vendosë gjendjen e mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

4. Kur Kuvendi nuk mund të mbledhet gjatë gjendjes së luftës, Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të nxjerrë akte që kanë fuqinë e ligjit, të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi në mbledhjen e tij më të parë.

5. Vendosja e paqes bëhet me të njëjtën procedurë si për shpalljen e luftës.

6. Presidenti i Republikës në kohë lufte, emëron dhe shkarkon nga detyra, me propozim të Kryeministrit, Komandantin e Forcave të Armatosura, një nga oficerët aktivë me grada madhore.

7. Komandanti i Forcave të Armatosura është eprori ushtarak më i lartë në gjendje lufte dhe përgjigjet para Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit për drejtimin e Forcave të Armatosura.

8. Vendimet e Komandantit të Forcave të Armatosura për përdorimin e Forcave të Armatosura në veprimet ushtarake në kohë lufte miratohen nga Presidenti i Republikës.

## Neni 34

### Kompetenca të tjera

Presidenti i Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ushtron të gjitha kompetencat e tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

## SEKSIONI 6

### MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA

## Neni 35

### Procedura e dekretimit të faljes së dënimit

1. Falja e dënimit ushtrohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë. Ajo mund të jetë tërësore ose e pjesshme.

2. Presidenti i Republikës, pas përcjelljes së dokumentacionit nga Ministri i Drejtësisë, si organi propozues për pranimin e kërkesës ose refuzimin e kërkesës për falje, shqyrton dokumentacionin përkatës, si dhe mund të kërkojë informacion shtesë nga organi propozues, ose individ, nëse e çmon të nevojshëm. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Presidenti duhet të shprehet mbi miratimin ose jo të propozimit për faljen.

3. Presidenti shprehet brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumentacionit, për faljen e personit. Kur Presidenti refuzon kërkesën për falje, brenda 5 ditëve, njoftohet personi i dënuar, personi që ka bërë kërkesën, dhe Ministria e Drejtësisë. Kur Presidenti nuk shprehet mbi kërkesën për falje, ajo konsiderohet si kërkesë e rrëzuar.

### **Neni 36**

#### **Procedura e dekretimit të fitimit, rikthimit dhe lejimit të heqjes dorë nga shtetësia shqiptare**

1. Fitimi, rikthimi dhe lejimi i heqjes dorë nga shtetësia shqiptare është kompetencë kushtetuese e Presidentit.

2. Presidenti i Republikës, brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit nga Ministria përgjegjëse për rendin publik, shprehet me dekret për fitimin, rikthimin ose lënien e shtetësisë shqiptare.

3. Presidenti i Republikës mund të anullopë/shfuqizojë dekretin e nxjerrë prej tij sipas pikës 2 të këtij neni ose mund të konstatojë pavlefshmërinë absolute të dekretit.

### **Neni 37**

#### **Procedura e dhënies së dekoratave dhe të titujve të nderit**

1. Dhënia e dekoratave dhe e titujve të nderit në nivel kombëtar është kompetencë e Presidentit të Republikës.

2. Presidenti mund t'i japë dekoratat dhe titujt e nderit kryesisht ose me propozim të organeve të përcaktuara me ligj. Komisioni Këshillimor për dhënien e dekoratave dhe titujve të nderit në nivel kombëtar, jep opinion mbi dhënien ose jo të dekoratave ose të titujve të nderit. Rregullat e funksionimit të këtij Komisioni miratohen nga Presidenti.

3. Presidenti mund të anullopë/ shfuqizojë dekretin për dhënien e dekoratave dhe titujve të nderit, nën vlerësimin e rrethanave apo fakteve të reja, që nuk justifikojnë arsyen e dekorimit.

### **Neni 38**

#### **Procedura e emërimit të Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit**

1. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit.

2. Presidenti i Republikës shqyrton propozimin për emërim ose shkarkim dhe brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij shprehet me dekret mbi pranimin ose refuzimin. Dekreti i shkarkimit duhet të jetë i argumentuar.

## Neni 39

### **Procedura e emërimit të Kryetarit të Akademisë së Shkencave**

Presidenti i Republikës emëron Kryetarin e e Akademisë së Shkencave, të zgjedhur nga Asambleja, sipas përcaktimeve të legjislacionit për Akademinë e Shkencave.

## Neni 40

### **Procedura e emërimit të rektorëve të universiteteve**

1. Presidenti i Republikës emëron rektorët e zgjedhur sipas dispozitave të legjislacionit për Arsimin e Lartë.

2. Presidenti i Republikës mund të shkarkojë rektorët e universiteteve, sipas përcaktimeve ligjore, me propozim të Ministrit përgjegjës për Arsimin. Presidenti shprehet me dekret të arsyetuar brenda 30 ditëve nga data e propozimit. Në rast moshpreheje, propozimi konsiderohet i miratuar nga Presidenti.

## Neni 41

### **Kërkimi i të dhënave me shkrim dhe mendimeve nga organet e administratës publike**

1. Nëse Presidenti kërkon mendime dhe të dhëna me shkrim nga institucionet publike, drejtuesit e tyre janë të detyruar t'ia dërgojnë atë, në përputhje me nenin 92 shkronja "h" të Kushtetutës. Në çdo rast informacioni, dokumentacioni apo çdo material tjetër i dërgohet Presidentit të Republikës brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet organeve hierarkike.

2. Institucionet e administratës shtetërore komunikojnë me Presidentin, nëpërmjet ministrit përgjegjës apo përkatësisht Kryeministrit.

## **KREU IV**

### **DEKRETET**

## Neni 42

### **Nënshkrimi dhe publikimi i dekreteve**

1. Presidenti i Republikës, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij nxjerr dekrete.
2. Dekretet e Presidentit të Republikës regjistrohen në librin e dekreteve të Presidentit të Republikës dhe marrin një numër rendor.
3. Procedura e nënshkrimit të dekreteve të Presidentit të Republikës përcaktohet sipas çështjeve të parashikuara nga Kushtetuta dhe në ligjet e nxjerra në zbatim të saj.
4. Dekretet e Presidentit të Republikës publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe i dërgohen për publikim Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

## Neni 43

### Hyrja në fuqi e dekretëve

Dekretet, si rregull, hyjnë në fuqi nga dita e miratimit të tyre, përveç rasteve përjashtimore, të përcaktuara në përputhje me procedurën e parashikuar në Kushtetutë.

## Neni 44

### Anullimi dhe shfuqizimi i dekretëve

1. Presidenti mund të anullosë ose shfuqizojë vetëm dekretet e nxjerra prej Tij, nëpërmjet një dekreti tjetër. Dekreti i Presidentit që nuk sjell pasoja, konsiderohet se nuk egziston.

2. Dekretet e Presidentit të natyrës administrative, janë objekt shqyrtimi gjyqësor, me kërkesën e subjektit që i është cenuar një e drejtë ose interes i ligjshëm, sipas rregullave të parashikuara me ligj.

## KREU V

### ORGANIZIMI I INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT

## Neni 45

### Organizimi

1. Organizimi dhe funksionimi i institucionit miratohen me dekret të Presidentit.
2. Presidenti mund të krijojë komitete këshillimore ad hoc, procedura e funksionimit e të cilëve dhe veprimtaria përcaktohen nga Presidenti.

## Neni 46

### Strukturat administrative

1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i Institucionit të Presidentit të Republikës. Sekretari i Përgjithshëm nën autoritetin e Presidentit, drejton veprimtarinë administrative të institucionit. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në legjislacionin për nëpunësin civil.

2. Sekretari i Përgjithshëm, nën autoritetin e Presidentit, drejton veprimtarinë administrative të institucionit. Ai ka këto detyra:

- a) përfaqëson Presidentin dhe Institucionin në veprimtari të ndryshme, përcjell mesazhe apo përsëndetje, dorëzon dekorata dhe tituj nderi të akorduara nga Presidenti i Republikës, me porosi të Presidentit të Republikës;
- b) nxjerr urdhra dhe udhëzime për mirëfunksionimin e veprimtarisë administrative të institucionit, në zbatim të dekretëve të Presidentit si dhe dispozitave ligjore;

- c) bashkëpunon me Kabinetin dhe drejton veprimtaritë zyrtare të Presidentit në mjediset e Institucionit të Presidentit të Republikës.
- d) drejton dhe bashkërendon punën e strukturave të tjera të institucionit dhe mban përgjegjësi për të gjithë veprimtarinë administrative.
- e) bën emërimin, lirin, lëvizje paralele, ngritje dhe ulje në detyrë të nëpunësve civilë dhe personelit mbështetës në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit për nëpunësin civil dhe kërkesat e Kodit të Punës, si dhe vë në dijeni Presidentin e Republikës;
- f) kryen edhe detyra të tjera të ngarkuara, rast pas rasti, nga Presidenti i Republikës.

3. Kabineti i Presidentit të Republikës përbëhet nga drejtori i kabinetit, këshilltarët, ndihmësit, sekretaria personale e Presidentit dhe sekretaria e kabinetit. Kabineti krijohet nga President i Republikës. Akti formal i emërimit, lirit, shkarkimit të anëtarëve të Kabinetit nxirret nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Kabineti i Presidentit asiston Presidentin e Republikës në shqyrtimin e të gjitha çështjeve brenda kompetencës së Tij/Saj dhe kujdeset për zbatimin e protokollit zyrtar. Me kërkesë të Presidentit të Republikës, apo me iniciativë, Kabineti i Presidentit jep mendime, që lidhen me:

- a) zbatimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Presidentit të Republikës;
- b) ruajtjen e sovranitetit të popullit dhe interesave kombëtare;
- c) lartësimin e imazhit të Presidentit të Republikës në mbrojtje dhe në respektim të institucioneve shtetërore;
- d) rritjen e efikasitetit të politikës së jashtme;
- e) mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

5. Kabineti i Presidentit kujdeset për takimet e përditshme që bëhen në zyrën e Presidentit të Republikës, lëvizjet dhe aktivitetet brenda territorit të Shqipërisë, në përputhje me ceremonialin zyrtar.

6. Anëtarët e Kabinetit të Presidentit, me përfundimin e mandatit presidencial, gëzojnë të drejtën e kthimit në vendin e mëparshëm të punës ose në institucionet e tjera shtetërore, sipas fushës së veprimtarisë që kanë ushtruar.

## **Neni 47**

### **Protokolli**

1. Institucioni i Presidentit ka veçoritë dhe specifikat e tij në zbatimin e protokollit zyrtar, referuar Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i mandatit të Tij/saj shoqërohet gjatë gjithë periudhës nga një ceremonial i veçantë për të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të Tij.

2. Pranë Presidentit vepron një strukturë përkatëse që trajton drejtpërsëdrejti praktikat ceremoniale në shërbim të Presidentit të Republikës. Ajo përgjigjet për aktivitetin zyrtar të Presidentit dhe të Zonjës së Parë për jetën e përditshme me karakter formal ose joformal, lëvizjet brenda territorit të Shqipërisë, inagurime, pritje dhe vizita, takime dhe veprimtari të ndryshme publike.

## **Neni 48**

### **Dhuratat e pranuar nga Presidenti**

Dhuratat e Presidentit të Republikës që janë marrë gjatë veprimtarive dhe vizitave të tij zyrtare në shtetet e huaja, si dhe dhuratat të cilat janë dhënë nga përfaqësuesit e shteteve të huaja gjatë veprimtarive dhe vizitave të tyre zyrtare në Shqipëri janë pronë e shtetit shqiptar dhe mbahen në institucionin e Presidentit të Republikës. Këto dhurata, në varësi të llojit të tyre, mund të transferohen për ruajtje në muze, ndërsa dhuratat me vlerë mbahen në Bankën e Shqipërisë.

## **KREU VI**

### **STATUSI I PRESIDENTIT DHE I FAMILJES SË TIJ/SAJ**

#### **SEKSIONI I**

#### **TRAJTIMI I PRESIDENTIT DHE FAMILJES GJATË USHTRIMIT TË FUNKSIONIT**

##### **Neni 49**

##### **E drejta e pagës**

1. Presidenti i Republikës ka nivelin më të lartë të pagës në institucionet e administratës publike, buxhetore dhe jobuxhetore, dhe në asnjë rast nuk mund të zbritet për efekt të përcaktimit të pagës referuese.
2. Garancitë shoqërore për Presidentin e Republikës sigurohen sipas legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

##### **Neni 50**

##### **Kujdesi ndaj shëndetit**

Presidentit të Republikës i caktohen dy mjekë personalë, të cilët emërohen nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë me marrëveshje me Presidentin e Republikës. Shërbimet e kujdesit shëndetësor të ofruara për Presidentin e Republikës, paguhen nga buxheti i Institucionit të Presidentit të Republikës, në varësi të fondeve buxhetore të parashikuara.

##### **Neni 51**

##### **Garancitë shoqërore në rast sëmundje dhe aksidenti të Presidentit**

1. Nëse Presidenti i Republikës është i sëmurë dhe përkohësisht i paaftë të ushtrrojë detyrën, ose ndërkohë që ushtron funksionin, pëson një aksident, trajtohet sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore.
2. Në rast të dëmtimit gjatë një aksidenti të ndodhur gjatë ushtrimit të detyrës, Presidenti ka të drejtën e përfitimit të një kompensimi sipas shkallës së dëmtimit.
3. Masa e dëmtimit dhe vlerësimi i dëmshpërblimit përcaktohen nga një komision i posaçëm, i përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, ku marrin pjesë përfaqësues të institucioneve zbatuese të ligjit, përfshirë edhe një përfaqësues të Institucionit Presidentit të Republikës. Masa e dëmshpërblimit përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 52

### **Garancitë shoqërore në rast sëmundje dhe aksidenti të Zonjës së Parë**

1. Nëse Zonja e Parë ose shoqëruesja e Presidentit të Republikës dëmtohet gjatë një aksidenti, ndërkohë që ushtron detyrën, atëherë ai/ajo trajtohet sipas ligjeve në fuqi në fushën e Sigurimeve Shoqërore.

2. Në rast vdekjeje të Zonjës së Parë, masa e dëmshpërblimit i paguhet familjarëve referuar ligjeve në fuqi. Në çdo rast shkalla e aftësisë për punë dhe e dëmtimit përcaktohet nga Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë.

3. Masa e dëmshpërblimit referuar parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, mbulohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

## Neni 53

### **Trajtimi financiar i familjes së Presidentit, në rast të vdekjes gjatë kohëzgjatjes së mandatit**

1. Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës gjatë kohëzgjatjes së mandatit, bashkëshortja dhe fëmijët e mitur të Presidentit kanë të drejtë për kompensim mujor financiar. Shuma e kompensimit është e barabartë me shumën 50% të pagës që merr Presidenti i Republikës.

2. Bashkëshortja, të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni e gëzon në mënyrë të përhershme.

3. Nëse Presidenti i Republikës në momentin e vdekjes ka patur vetëm fëmijë të mitur, atë e gëzojnë të drejtën sipas pikës 1 të këtij neni deri në mbarimin e shkollimit të rregullt, respektivisht deri në moshën 25 vjeçare.

## Neni 54

### **Privilegje të tjera të familjes së Presidentit, në rast të vdekjes gjatë kohëzgjatjes së mandatit**

1. Në rast të vdekjes të Presidentit të Republikës gjatë kohëzgjatjes së mandatit, familjes së tij i sigurohen sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave:

- a) ambiente zyrtare sipas nevojës për pritje dhe përcjellje zyrtare;
- b) strehim sipas nevojës;
- c) siguri personale;
- d) e drejta e përdorimit të makinës zyrtare dhe shofer.

2. Kohëzgjatja e përfitimit të privilegjeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni është jo më shumë se 1 vit.

## Neni 55

## **Sigurimi i kryerjes së funksioneve të përcaktuara në Protokollin e Shtetit dhe/ose diplomatik për bashkëshorten e Presidentit**

Kur Zonja e Parë ose personi shoqërues është i punësuar, atij/asaj i jepet leje për mungesë në punë për të kryer funksionet e përcaktuara në protokollin e shtetit dhe /ose atyre diplomatike dhe paguhet për këtë kohë në vlerë të njëjtë me pagën e Presidentit nga Zyra e Presidentit të Republikës. Zonjës së Parë ose personit shoqërues do t'i rimbursohen shpenzimet që kanë të bëjnë me përfaqësimin brenda vendit dhe gjatë vizitave të huaja në përputhje me praktikën ndërkombëtare diplomatike, si dhe dietat përkatëse referuar legjislacionit.

### **Neni 56**

## **Garancitë e trajtimit të Kreut të Kuvendit gjatë kohës të ushtrimit të kompetencave të Presidentit të Republikës**

Kryetari i Kuvendit gjatë kohës që ushtron këtë funksionin e Presidentit të Republikës sipas rasteve të parashikuara në nenin 91 të Kushtetutës, përfiton të gjitha garancitë e Presidentit të Republikës. Bashkëshortja ose personi shoqërues i Kryetarit të Kuvendit gëzon të gjitha garancitë e Zonjës së Parë apo personit shoqërues të Presidentit të parashikuar në këtë ligj.

## **SEKSIONI II**

## **TRAJTIMI I PRESIDENTIT DHE FAMILJES PAS PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIT**

### **Neni 57**

#### **E drejta për mbajtjen e titullit**

Personi i cili ka shërbyer si President i Republikës do të mbajë titullin e Presidentit të Republikës përjetë, përveç rasteve kur gjykata vendos heqjen e titullit.

### **Neni 58**

#### **E drejta për pension**

1. Presidenti i Republikës pas mbarimit të mandatit, ka të drejtë për pension suplementar referuar legjislacionit për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit.

2. Presidenti i Republikës pas mbarimit të funksionit, mund të përfitojë shpërblime të tjera nga shteti, por shuma e tyre nuk mund të kalojë shumën e pagës së Presidentit në detyrë.

### **Neni 59**

#### **E drejta për banesë**

Presidenti i Republikës i cili ka përfunduar mandatin e tij, përveç rastit të shkarkimit, i sigurohet një sipërfaqe për banim, pa pagesë, për përdorim në përputhje me procedurën e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 60**

##### **E drejta për sigurim personal**

Presidenti i Republikës, i cili ka përfunduar mandatin e tij, përveç rastit të shkarkimit, i sigurohet mbrojtje personale nga Departamenti i Personaliteteve, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për rendin publik, në përputhje me procedurën e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 61**

##### **E drejta për staf mbështetës dhe ambiente zyre**

1. Presidenti i Republikës, të cilit i ka mbaruar mandati, përveç rastit të shkarkimit, ka të drejtë: (i) për ambient zyre deri në 100 m<sup>2</sup> për kryerjen e aktivitetit të Tij; (ii) staf mbështetës të përbërë nga të paktën dy persona, dhe të drejtën e shfrytëzimit të makinës zyrtare dhe shoferit.

2. Personat ndihmës të drejtat për marrëdhënie pune i realizojnë me institucionin e Presidentit të Republikës, ndërsa emërohen dhe shkarkohen nga Sekretari i Përgjithshëm, me propozim të ish kreut të shtetit, të cilit i ka mbaruar mandati. Shpenzimet për shfrytëzimin e makinës zyrtare përballohen nga buxheti i Presidentit të Republikës në detyrë.

#### **Neni 62**

##### **E drejta për mbulim shpenzimesh shëndetësore dhe në rast vdekjeje**

1. Presidentit të Republikës, të cilit i ka mbaruar funksioni, përveç rastit të shkarkimit, në rast sëmundje, shpenzimet mjekësore të Tij dhe të familjes i mbulohen nga buxheti i shtetit.

2. Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës, të cilit i ka mbaruar mandati, ceremonia mortore kryhet me nderime shtetërore dhe shpenzimet e shtetit, nëse nuk ka shprehur dëshirë tjetër.

#### **Neni 63**

##### **E drejta për pjesëmarrje në aktivitete dhe ceremoniali**

Presidenti i Republikës, të cilit i ka mbaruar mandati, merr pjesë në ceremonitë zyrtare duke zënë vend pas Presidentit të Republikës në detyrë, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe pas Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

## Neni 64

### **Privilegje të tjera të Presidentit dhe familjes**

Pas mbarimit të funksionit, Presidenti i Republikës, dhe anëtarët e tjerë të familjes ruajnë privilegjet dhe pasaportat diplomatike. Presidenti i Republikës, të cilit i ka mbaruar mandati, ka të drejtë për shpenzimet materiale për nevojat e realizimit të aktiviteteve të tij. Këto shpenzime sigurohen nga buxheti i shtetit, në përputhje me procedurën e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 65

### **E drejta e gëzimit të pensionit pas vdekjes së Presidentit**

Në rast të vdekjes së Presidentit të Republikës pas mbarimit të mandatit, pensionin e përcaktuar në nenin \_\_\_ të këtij ligji, të zvogëluar në masën 50%, e gëzojnë bashkëshortja e tij dhe fëmijët e mitur, deri në mbarimin e shkollimit të rregullt, respektivisht deri në moshën 25 vjeçare.

## **KREU VII**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

## Neni 66

### **Shtrirja e efekteve të seksionit II të Kreut V**

Të drejtat dhe privilegjet e tjera që i lindin Presidentit të Republikës pas përfundimit të mandatit, sipas përcaktimeve të këtij ligji i gëzojnë edhe Presidentët e Republikës, të cilët kanë qënë në funksionin e kryetarit të shtetit pas datës 31 mars 1991.

## Neni 67

### **Ligji i zbatueshëm për procedurat e nisura<sup>5</sup>**

## Neni 68

### **Shfuqizime**

Çdo dispozitë ligjore e nënligjore që bie në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, shfuqizohet.

## Neni 69

<sup>5</sup> Do të plotësohet në varësi të kapitullit mbi funksionet kushtetuese të Presidentit.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve \_\_\_\_\_ të këtij ligji.

**Neni 70**

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

[shqiptarja.com]